

PROGRAMI ORIENTUES PËR KRYERJEN E TESTIMIT TË KANDIDATËVE **INFERMIERË**

1. HYRJE

Programi orientues për kryerjen e procedurës së testimit të kandidatëve infermierë u vjen në ndihmë të gjithë profesionistëve të diplomuar pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike për t'u përgatitur për testimin për punësim në vendet vakante në institucionet shëndetësore publike.

Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e infermierëve, të tilla si:

- aspekte që lidhen me akte rregullatore mbi profesionin e infermierit në Republikën e Shqipërisë.
- aspekte që lidhen me etikën dhe komunikimin e infermierit në institucionin shëndetësor.
- aspekte të lidhura me disiplina të fushës së infermieristikës sipas niveleve të kujdesit shëndetësor.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT ORIENTUES

Programi orientues ka për qëllim primar të mbështesë përgatitjen për testim të kandidatëve infermierë si dhe të nxitë ata në zhvillimin e kompetencës së tyre profesionale. Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së infermierëve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit shëndetësor në fushën e infermieristikës.
- Rritjen e aftësive dhe të kompetencave profesionale të infermierëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit në ofrimin e kujdesit infermieror në institucionet shëndetësore publike.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së infermierëve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në institucionet shëndetësore publike.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për përgatitjen për testim të kandidatëve infermierë është strukturuar sipas fushave kryesore të ushtrimit të kompetencave profesionale infermiere të përmendura më sipër. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë infermieri sipas nivelit të kujdesit shëndetësor ku do të ofrojë shërbimin infermieror (parësor ose spitalor), me qëllim përmbushjen me sukses të rubrikave të testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të infermierit. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit

do ta ndihmojnë infermierin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë në të ardhmen.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është prezantuar sipas formatit të mëposhtëm, me fushat kryesore sipas të cilave infermieri duhet zotërojë njohuritë dhe aftësitë e tij, si dhe literaturën përkatëse rekomanduese që i ndihmon në përvetësimin e tyre.

KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR

1. Karakteristikat dhe parimet e kujdesit shendetësor parësor
2. Etika profesionale dhe komunikimi
3. Promocioni dhe edukimi shendetësor
4. Depistim, ekzaminime laboratorike
5. Kujdesjet në raste urgjencash
6. Kujdesi shendetësor për fëmijët
7. Këshillimi në planifikimin familjar dhe metodat kontraceptive
8. Kujdesejet shendetësore për të rriturit dhe të moshuarit
9. Kujdesi paliativ
10. Kujdesi shendetësor tek gratë, gruaja shtatzanë dhe shëndeti riprodhues
11. Kujdesjet shendetësore mendore
12. Menaxhimi i dhimbjes
13. Sëmundjet kronike

KUJDESI SHËNDETËSOR SPITALOR

1. Bazat e Infermieristikës
2. Etika dhe komunikimi
3. Infermieristika e Sëmundjeve të Brendshme, Dermatologji, Okulistikë, Psikiatri, Neurologji.
4. Infermieristika në Pediatri
5. Infermieristika në Obstetrikë - Gjinekologji
6. Infermieristika në Kirurgji
7. Infermieristika në Anestezi-Reanimacion
8. Infermieristika në Sëmundjet Infektive
9. Infermieristika në Traumatologji
10. Fizioterapia në Infermieri

KUJDESI SHËNDETËSOR TERCIAR

1. Aparati lokomotor
2. Dekubituset
3. Eliminimi
4. Etika dhe komunikimi
5. Gjumi dhe pushimi
6. Infeksionet Spitalore
7. Lëngjet dhe elektrolitet
8. Medikamentet

9. Menaxhimi i dhimbjes
10. Oksigjenimi
11. Shenjat Vitale – Siguria e pacientit
12. Stresi
13. Testet diagnostike
14. Urgjenca
15. Ushqyerja
16. Higjenë – të tjera

LITERATURA E REKOMANDUAR

- Kirurgjia e Përgjithshme. Autorët: Skënder Topi, Ilia Mazniku, Albana Cela
- Kirurgjia Speciale. Autorët: Skënder Topi, Ilia Mazniku, Albana Cela
- Anestezia dhe Reanimacioni. Autorët: Vjollca Shpata, Ilir Ohri, Kiri Zallari
- Patologjia Morfologjike. Autorët: Mehdi Alimehmeti, Majlinda Buda.
- Infermieristika në Specialitete. Autorët: Ledio Nace, Elida Peka, Alma Imami, Miranda Cela, Valbona Bilali.
- Sëmundje të brendshme. Autori: Petrit Bara
- Urgjencat Mjekësore. Autori: Petrit Bara
- Fiz-Patologjia. Autori : Petrit Bara
- Shëndeti Publik. Autorët: Jonida Stefa, Petrit Bara, Enver Roshi, Genc Byazeri.
- Pediatria. Autorët: Edmond Pistuli

Akte ligjore

- Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (me Ligjin nr. 51/2013 dhe Ligjin Nr. 76/2015)
- Ligji Nr.9718, datë 19.4.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligjin Nr.10 462, datë 13.9.2011 dhe Ligjin Nr. 124/2014)